

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tromp: Serbia do ta shfrytëzojë aktgjykimin si armë juridike kundër Kosovës
ADRESA	https://albeu.com/kosove/tromp-serbia-do-ta-shfrytezoje-aktgjykimin-si-arme-juridike-kunder-kosoves/1016301/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 15:58:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:54:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	09cbb496d51eeb8451aa42380b83f822fe92d26b0168eb142dbc0e3d72f5c22c
TEKSTI	de96a53b90534ef8c0055afb706fb17179099db9209710d5d388f7786c1ccf3
PAMJA	973d9997dd18f4fec257fb53ab5d0b8187ab99977ebdd0704fbb49fc9108ca87

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	80a2f23f82a4576d8117c237d6128a91d07a055034761c280f0ad3e766e6e4ed
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7da1a16455667271a66d1d30122b5a20135397a682b3b58f5cc074dfa4984ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/80a2f23f82a4576d8117c237d6128a91d07a055034761c280f0ad3e766e6e4ed>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Tromp: Serbia do ta shfrytëzojë aktgjykimin si armë juridike kundër Kosovës



Nevenka Tromp, studiuese, profesoreshë, autore dhe ish-hetuese e Tribunalit për Krime Luftë në Ish-Jugosllavi (ICTY), ka kritikuar aktgjykimin dënues të Dhomave të Specializuara ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Në një intervistë për KosovaPress, të dhënë një ditë pas shpalljes së vendimit, ajo trajtoi si aspektin njerëzor të dënimeve, ashtu edhe pasojat politike që mund të sjellë aktgjykimi.

Në bisedën me gazetarin Besart Maloku, Tromp foli gjithashtu për rolin e Thaçit në themelimin e Dhomave të Specializuara, bashkëpunimin e tij me drejtësinë, mundësinë që Serbia ta shfrytëzojë vendimin, procedurën e apelit dhe çështje të tjera.

Tromp zgjodhi që analizën ta niste nga përvoja personale e katër të dënuarve, duke theksuar se drejtësia duhet vlerësuar fillimisht përmes ndikimit që ka te individët.

Sipas saj, momenti i leximit të aktgjykimit dhe shqiptimit të dënimeve duhet të ketë qenë jashtëzakonisht i rëndë për katër të akuzuarit, të cilët qëndronin të ulur dhe dëgjonin vendimin. Ajo tha se vëmendja duhet të rikthehet gjithmonë te dimensionin njerëzor, edhe pse diskutimi publik tashmë është përqendruar te ndikimi mbi Kosovën dhe marrëdhëniet me Serbinë. Në thelb, shtoi Tromp, drejtësia duhet parë para së gjithash në raport me individin.

Ajo rikujtoi se tre prej tyre ishin studentë kur e ndërprejnë jetën e zakonshme dhe vendosën t'i bashkoheshin luftës. Tromp theksoi se ata erdhën edhe nga jashtë për të luftuar jo vetëm për vendin, por edhe për motrat, vëllezërit, nënat dhe gratë e tyre, ndonëse kishin mundësi të ktheheshin dhe të zgjidhnin një rrugë tjetër.

Sipas saj, ata luftuan në vijën e parë dhe, me mbështetjen e vendeve të NATO-s, e fituan luftën. Pas përfundimit të saj, vazhduan të punonin për shtetësinë e Kosovës. ndërsa tani po paqumë cmimin e vendimeve që morën

të fundit /



Tromp: Serbia do ta shfrytëzojë aktgjykimin si armë juridike kundër Kosovës



Vendimi i Hagës dhe ndikimi i tij në historinë e luftës së Kosovës



Debati për pagat e gjyqësorit, EAJ kundërshton...



Bosch sugjeron se presidenti i ardhshëm i Kosovës mund t'i falë...



Restoranti me dy yje "Michelin" shërbeu sorbet me milingona t...



Gjendet në pellg trupi i 3-vjeçarit, babai: Noah ishte i ëmbël, i...



82-vjeçari nga Kosova ndërron jetë në plazhin e Velipojës



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

kur ishin në të njëzetat. Tromp tha se e gjithë jeta e tyre iu kushtua një kauze të madhe dhe se ata bënë sakrifica të mëdha në raport me familjet dhe fëmijët e tyre.

Ajo nënvizoi se dënimi me 25 vjet burgim për Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin, i cili është pak më i moshuar se të tjerët, përbën de facto burgim të përjetshëm.

Tromp kritikoi edhe disa deklarata të kryetarit të trupit gjykues, Charles Smith. Ajo e konsideroi ironike formulimin se vendimi po merrej "në emër të popullit të Kosovës", duke iu referuar njëkohësisht protestave të qytetarëve kundër aktgjykimit të Dhomave të Specializuara.

Sipas saj, ishte ironike që gjykatësi e përsëriste se po vepronte në emër të qytetarëve të Kosovës për shkak se bëhej fjalë për një gjykatë të Kosovës, ndërkohë që jashtë po zhvilloheshin demonstrata masive, të cilat mund të ndiqeshin online. Tromp tha se një numër shumë i madh qytetarësh po shprehnin pikërisht qëndrimin se ajo nuk ishte një gjykatë në emrin e tyre.

Ajo e quajti shqetësuese edhe deklaratën e gjyqtarit se aktgjykimi nuk ishte kundër popullit të Kosovës, luftës çlirimtare apo UÇK-së si organizatë.

Tromp ngriti pyetjen se mbi çfarë baze një gjyqtar mund të përcaktojë mënyrën se si do të interpretohet vendimi, veçanërisht nga Serbia. Ajo pyeti nëse gjykatësi ishte në kontakt me presidentin serb Aleksandar Vuçiq për t'i kërkuar që të mos i keqinterpretonte apo keqpërdorte fjalët e drejtësisë për vazhdimin e asaj që ajo e quajti luftë speciale kundër Kosovës.

Sipas Tromp, Serbia nuk e ka pranuar asnjëherë se është mposhtur ushtarakisht dhe nuk ka hequr dorë nga pretendimet territoriale, të paktën ndaj një pjese të Kosovës. Ajo pyeti nëse gjykata dhe gjyqtari do t'i kërkonin Beogradit ta pranonte këtë realitet dhe ta njhte pavarësinë e Kosovës, duke theksuar se kjo nuk do të ndodhë.

Tromp paralajmëroi se Serbia do ta përdorë aktgjykimin për të vijuar atë që ajo e përkufizon si "lawfare", pra përdorimin e ligjit si mjet lufte. Sipas saj, pasi nuk arriti ta fitonte konfliktin, Serbia tani do të përdorë argumente juridike për t'u rikthyer dhe për t'i ringjallur aspiratat territoriale në Kosovë. Këtë herë, shtoi ajo, Beogradi do ta ketë aktgjykimin si mjet për t'i bindur ndërkombëtarët që ta lënë të qetë.

Në intervistë u trajtua edhe angazhimi i Thaçit në krijimin e Dhomave të Specializuara, të cilin trupi gjykues e përmendi gjatë shqiptimit të vendimit si rrethanë lehtësuese.

Tromp e cilësoi shumë cinike dhe mizore mënyrën se si gjyqtari iu referua kësaj rrethane. Ajo tha se mes arsyeve të renditura për një dënim më të ulët ndaj Thaçit ishte fakti se ai kishte luajtur rol vendimtar në themelimin e gjykatës. Megjithatë, sipas saj, "butësia" e paralajmëruar përfundoi në një dënim prej 25 vjetësh, që praktikisht është burgim i përjetshëm.

Duke shpjeguar kontekstin politik të krijimit të Dhomave të Specializuara, Tromp tha se Thaçi ishte vënë nën presion të jashtëzakonshëm nga miqtë më të mëdhenj të Kosovës në atë periudhë: Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian.

Sipas saj, ai pothuajse nuk kishte alternativë, pasi u besonte partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës. Tromp kundërshtoi pretendimet e shfaqura shpesh në opinionin publik se Thaçi mund të kishte bërë pazar ose të kishte negociuar ndonjë marrëveshje për të mos u akuzuar, duke thënë se faktet tashmë tregojnë se një ide e tillë është e pakuptimtë.

Ajo deklaroi se Thaçi mori në atë kohë një vendim jashtëzakonisht të vështirë prej burri shteti. Sipas Tromp, ai pranoi krijimin e Dhomave të Specializuara sepse ishte plotësisht i bindur se nuk kishte rrugë tjetër dhe besonte se kjo do ta përshpejtonte procesin e shtetësisë së Kosovës.

Tromp theksoi se Thaçi veprroi kështu edhe pse e dinte se mundësitë që ai vetë të akuzohej ishin shumë të larta. Ajo tha se, si burrë shteti, ai e vendosi Kosovën përpara interesit të tij personal.

Në këtë kuadër, Tromp foli edhe për bashkëpunimin e ish-presidentit të Kosovës me organet e drejtësisë. Ajo kujtoi se Thaçi kishte të drejtë të mos fliste dhe t'ia linte Prokurorisë të gjithë barrën e provës, por ai zgjodhi t'u përgjigjej pyetjeve të saj.

Sipas Tromp, pas fitores së luftës ndaj Serbisë, Kosova synonte të bëhej pjesë e familjes demokratike të shteteve të botës dhe të zhvillohej si demokraci liberale. Për këtë arsye, Thaçi nuk mund ta refuzonte sistemin ndërkombëtar të drejtësisë penale, të cilin ajo e përshkroi si një nga shtyllat e rëndësishme të demokracisë liberale.

Ajo tha se Thaçi nuk mund të ndiqte rrugën drejt liberalizmit dhe demokracisë, ndërsa në të njëjtën kohë të përjashtonte drejtësinë penale ndërkombëtare. Edhe pasi u akuzua, ai bashkëpunoi. Madje, ende në detyrën e presidentit dhe para ngritjes së akuzës, dha një numër intervistash për Prokurorinë.

Tromp u ndal gjithashtu te apeli i verdiktit të Dhomave të Specializuara. Ajo u shpreh e bindur se apeli është i domosdoshëm dhe se do të bëhet, por paralajmëroi se procedura mund të zgjasë deri në pesë vjet.

Ajo sqaroi se deri tani e kishte parë përmbajtjen e aktgjykimit vetëm përmes përmbledhjes dhe se vendimi i plotë duhet të lexohet nga të gjithë. Sipas saj, ndryshe nga rastet e ICTY-së dhe ICC-së, Kosova nuk ndodhet në një pozitë aq të pafavorshme sa i përket trajtimit të vendimit në apel, pasi fjalën e fundit do ta ketë Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Megjithatë, Tromp theksoi se rruga mbetet e gjatë. Katër ish-krerët e UÇK-së kanë kaluar tashmë 6 vjet në paraburgim dhe tani përballen me dënime deri në 25 vjet. Sipas saj, një lloj përfundimi mund të arrihet gjatë 5 viteve të ardhshme.

Ajo pranoi se procesi i zgjatur gjyqësor tashmë e ka minimizuar rolin e tyre në shoqërinë kosovare, duke i reduktuar funksionet e tyre pothuajse në asgjë. Tromp paralajmëroi se ata janë vendosur në një situatë ku mund të shndërrohen në martirë, ndërsa Kosovës, sipas saj, nuk i duhen martirë të tjerë.

Ajo tha se Kosova ka lënë shumë martirë në fushat ku u zhvillua lufta kundër agresionit serb. Sipas Tromp, vendit i nevojiten njerëz të aftë dhe me përvojë për të vazhduar punën e vështirë të ndërtimit të institucioneve shtetërore dhe forcimit të pavarësisë së shtetit të Kosovës.

Shtuar më 17.09.2026 17:54

Tags: [Nevenka Tromp](#), [Tribunali](#)



Vendimi i Hagës dhe ndikimi i tij në historinë e luftës së Kosovës



Bosch sugjeron se presidenti i ardhshëm i Kosovës mund t'i falë të...



82-vjeçari nga Kosova ndërron jetë në plazhin e Velipojës



Pas dënimit të djeshëm të krerëve të UÇK-së, gjyqtari Smith hap procedurën për...



Kuvendi dënon vendimin e Hagës për ish-krerët e UÇK-së: Besojmë në...



Pas vendimit të Hagës për ish-drejtesit e UÇK-së, Kuvendi shqiptar miraton...



Shefi i Komitetit Ushtarak të NATO-s takohet me komandantin e ardhshëm...



Pas 81 viteve burg në shkallën e parë, vendimi për katërshen kalon në...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

[Kontaktimi](#) | [Kushtet e Përdorimit](#) | [Privacy Policy](#) | [Powered by: orihost.com](#)